



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**AD.GJTH.GJL.nr.2/25**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas autorizimeve ligjore për iniciimin e procedurës disiplinore sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Gjilan, bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më datë 13.02.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**NUK kërkohet fillimi i hetimeve disiplinore** ndaj gjyqtarit N. M., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda.

**A r s y e t i m**

Më datë 17.01.2025 në portalin/gazetën “Betimi për Drejtësi” është publikuar hulumtimi me titullin “Gjykatësi N. M. pëlqen videon e Kurtit në Facebook, thotë se “bën vaki” ia kanë bërë fëmijët”. Në përmbajtje të këtij hulumtimi është shtjelluar se gjyqtari i kësaj gjykate, N. M. nga llogaria e tij në rrjetin social Facebook ka pëlqyer një video ku shihet Kryeministri Albin Kurti me zyrtarë të tjerë të Vetëvendosjes në një restorant në Podujevë, i cili në videon e publikuar flet lidhur me zgjedhjet e ardhshme dhe duartrokitet nga të pranishmit. I kontaktuar nga ekipa e “Betimit për Drejtësi”, gjyqtari në fjalë ka thënë se nuk e ka bërë një gjë të tillë, vetëm nëse ia kanë marrë telefonin fëmijët, duke cituar fjalët “Jo, jo, s’di as nuk i këqyri këto sene. Bën vaki e kam lanë çelë, e kanë marrë fëmija e kanë këqyrë aty..., ai like nuk është është bërë me vetëdije..., jo jo, çfarë...”. Hulumtimi është përmbjllur me përmbajtjen e nenit 2.2.4 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, ku theksohet se “Gjyqtari përmbahet nga sjelljet që mund të japin përshtypje te publiku se është politikisht aktiv, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në aktivitetet politike në formë përkrahjeje të ndonjë nga anëtarët e familjes së ngushtë dhe përmes çdo forumi apo mediumi, duke përfshirë mediat sociale”.

Më datë 31.01.2025, kryetari i gjykatës si autoritet kompetent ka kërkuar nga gjyqtari N. M. që të deklarohet lidhur me këtë publikim dhe të njoftojë nëse ka bërë ndonjë pëlqim në rrjetin social Facebook.

Gjyqtari N. M. më datë 03.02.2025 ka deklaruar se nuk ka asnjë ide se ka bërë ndonjë pëlqim të tillë. Telefoni i tij nuk ka asnjë kod dhe e shfrytëzojnë për të shikuar në Youtube dhe për të luajtur nipat e tij A. M. – 6

vjeçar dhe D. M.– gati 2 vjeçar, andaj është e mundur që ata gjatë shikimit në telefon kanë mundur të shtypin sustën për pëlqime. E ka kontrolluar menjëherë Facebook-un dhe e ka hequr këtë pëlqim, e nuk ka mundur të gjej pëlqime tjera.

Kryetari i gjykatës si autoritet kompetent, shqyrtoi hulumtimin e publikuar nga portali “Betimi për Drejtësi” dhe deklaratën e gjyqtarit për të iniciuar sipas detyrës zyrtare fillimin e hetimit disiplinor, mirëpo gjeti se nuk ka bazë të arsyeshme të besojë se gjyqtari N. M. ka kryer shkelje disiplinore.

Në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është përcaktuar se “Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik dhe e cila nuk është hedhur poshtë sipas nenit 9, paragrafit 6 të këtij Ligji, ose sipas detyrës zyrtare kur ka bazë të arsyeshme të besojë se një gjyqtar ose prokuror ka kryer shkelje disiplinore”. Në rastin konkret, meqë nuk kemi të bëjmë me ankesë të paraqitur nga ndonjë person, kryetari i gjykatës vlerësoi rrethanat se a ka bazë të arsyeshme për të iniciuar procedurën disiplinore.

Kryetari i gjykatës bazuar në parimet e përgjegjësisë disiplinore - parimet e ligjshmërisë, respektimit të pavarësisë së gjyqësorit, gjykimit të drejtë, proporcionalitetit, transparencës dhe llogaridhënies (neni 3 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve) vlerëson se iniciimi i procedurës disiplinore nuk është në përputhje me këto parime, pasi nga vet deklarimi i gjyqtarit N. M. në gazetën e cila ka bërë këtë hulumtim si dhe në deklaratën e dhënë kryetarit të gjykatës, konkludohet se nuk kemi të bëjmë me veprim të marrë personalisht, por me veprime të ndërmarra nga fëmijë të moshës së vogël që kanë përdorur dhe shfrytëzuar telefonin e gjyshit të tyre – këtu gjyqtarit në fjalë.

Në këto rrethana, nga deklarimi i gjyqtarit N. M. se i njëjti nuk e ka pëlqyer personalisht videon e publikuar me përmbajtje politike, por se rrjetin social të tij Facebook kanë mundur ta shfrytëzojnë fëmijët e tij dhe se i njëjti as nuk ka njohuri për këtë pëlqim, kryetari i gjykatës vlerëson se nuk plotësohen kushtet që të besohet se me këto veprime është kryer shkelja disiplinore e krijimit të përshtypjes te publiku se është politikisht aktiv, përmes përkrahjes në mediat sociale (neni 5, paragrafi 2, pika 2.11 e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve lidhur me nenin 2.2.4 i Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë).

Kryetari i gjykatës si autoritet kompetent ia fali besimin deklaramit të gjyqtarit lidhur me këtë çështje, duke marrë për bazë edhe faktin se përdorimi i rrjeteve sociale për një moshë të caktuar nuk është i krahasueshëm njëjtë me moshën që i njohin mirë teknologjinë e rrjetet sociale. Kryetari i gjykatës gjithashtu vlerësoi edhe faktin se gjyqtari ka hequr pastaj pëlqimin nga kjo video e publikuar. Për më tepër, gjatë fazës së vlerësimit të gjyqtarëve ka rubrikë të veçantë edhe pjesa e përdorimit të rrjeteve sociale, që është kompetencë e kryetarit të poentojë gjyqtarin në vlerësim.

Prandaj, nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,  
Venhar Salihu**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit N. M.,
2. KGJK-së,
3. Dosjës së lëndës.